REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI I BASHKISË

Nr.3201 Prot. Maliq, më 12.06.2025

PROJEKT -VENDIM - Nr. 14

Nr. 14 datë 12.06.2025

Për

"Ngritjen e Bordit Artistik të Bashkisë Maliq"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*" neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika1.1, shkronjat b) dhe d), neni 25, neni 55, pika 2 dhe 6 , ligjit 10352 , datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën" i ndryshuar neni 28, pika 2 dhe 3 , Ligjit 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" të ndryshuar i kërkojmë Këshillit të Bashkisë

1. Ngritjen e Bordit Artistik pranë Bashkisë Maliq të përbërë nga 5 anëtarë;
2. Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar dhe e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për organet kolegjiale ;
3. Bordi artistik miraton rregulloren e tij të organizimit dhe funksionimit si dhe miraton listën e aktiviteteve kulturore – artistike dhe ja paraqet Kryetarit të Bashkisë për miratim;
4. Kryetari i Bashkisë miraton listën emërore të Bordit Artistik
5. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Sektori i Kulturës pranë Agjencisë të Shërbimeve Mbështetëse në bashki.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Korçë .

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

RELACION

3201

12.6.25

Mbi

"Ngritjen e Bordit Artistik të Bashkisë Maliq"

Bordi Artistik është një institucion i cili do të merret me politikat kulturore, artistike e letrare në Bashkinë Maliq, me rakordimin e veprimtarive brenda bashkisë si dhe me institucione të tjera kombëtare e ndërkombëtare.

Bazuar në vendimmarrjen që ju do të merrni bordi artistik do të hartojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit si dhe do të miratojë listën e aktiviteteve kulturore-artistike vjetore dhe të ndarë në periudha për të gjithë vitin.

Kemi mendimin se ky bord është shumë i rëndësishëm për të bërë të mundur edhe sjelljen e mendimeve dhe propozimeve konkrete, futjen e mendimit kritik si dhe thithjen e atyre talenteve dhe aktiviteteve të cilat do të përmirësojnë jetën kulturore-artistike në qytet e në të gjithë territorin e Bashkisë Maliq .

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ